

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	21.02	2023	
Nj. Org.	Numer	Smajca	Vlera
01-060/04-9198			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas



Drenas, 20 shkurt 2023

Për: **Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit**

Nga: **Arton Hasani, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave**

Lënda: **Raporti (me komente) mbi ecurinë e hartimit të Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027**

Ky dokument është një raport përmbledhës mbi ecurinë e hartimit të Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027, komentet dhe trajtimi i tyre nga grupi punues.

NARRATIVI

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5-Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17- Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me datë 23.11.2023, Kryetari i Komunës së Drenasit ka nënshkruar vendimin për formimin e Komisionit Komunal për hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027.

Komisioni ka për detyrë hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë, dërgimin e draft-Planit për konsultim publik, si dhe të gjitha procedurat tjera ligjore deri në miratimin e këtij Plani.

Komisioni Komunal për hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027, përbëhet nga:

1. **Bekim Dobra**-kryetar i komisionit;
2. **Altina Mulaj-Hajdini**-anëtare;
3. **Avdyl Mziu**-anëtar;
4. **Liridona Fejza-Ajazi**-anëtare; dhe,
5. **Arton Hasani**-anëtar.

AKTIVITETET

Lidhur me draft-Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027, grupi punues mbajti **takimin e parë** të këtij lloji me datë: **30.11.2022**. Kryetari i komisionit të grupit punues, **Bekim Dobra**, ka informuar anëtarët tjerë për rëndësinë e Planit duke theksuar se; ky plan është punuar me zyrtarë të projektit DEMOS, i cili ka në fokus transparencën dhe llogaridhënien si elementet thelbësorë të qeverisjes së mirë në nivelin lokal.

Anëtarët tjerë të grupit punues u njoftuan nga kryetari i komisionit me detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë në hartimin e këtij plani, duke dhënë kështu rekomandimet dhe sugjerimet e tyre njëkohësisht.

Anëtarët e komisionit, pranuan koncept-dokumentin ku edhe premtuan se brenda afatit kohor, do ti paraqesin sugjerimet dhe rekomandimet për hartimin final të këtij Plani.

Takimi i dytë me komisionin komunal për hartimin e draft-Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027 u mbajt me datë: **29.01.2023**

Kryetari i komisionit, **Bekim Dobra**, tregoi gatishmërinë edhe të kryetarit të komunës, Ramiz Lladrovci, që secilin dokument ta ndaj dhe ta diskutoj me qytetarët. Tutje, kryetari i grupit punues shprehu gatishmërinë në pranimin dhe inkorporimin e të gjitha komenteve të qytetarëve, gjithmonë në sajë të ligjshmërisë. Gjithashtu, tha se në faqen dy të dokumentit duhet ndryshohet teksti nga Deklarata e Transparencës në Fjala e Kryetarit. Po ashtu edhe tek pjesa e objektivave dhe aktiviteteve, të përshtaten me qëllimet e komunës lidhur me transparencën komunale. Komuna jonë, njihet për performancë dhe transparencë të plotë, ndaj kërkoj nga secili anëtarë të jap idetë dhe sugjerimet profesionale që ky plan të jetë sa më unik dhe zbatues, e që do të përmirësoj edhe më shumë transparencën komunale.

Altina Mulaj-Hajdini-si anëtare e komisionit për hartimin e këtij plani, sugjeroi azhurnimin e ligjeve dhe rregulloreve administrative që janë të paraqitura në koncept-dokumentin e hartuar me zyrtarët e projektit DEMOS.

Ligje dhe rregullore të tilla definojnë procedurat e zbatimit të instituteve të shumta juridike për transparencë, duke përcaktuar zyrtarët përgjegjës, format dhe teknikat për transparencë, si dhe afatet procedurale, tutje theksoi ajo.

Avdyl Mziu-sugjeroi se tek pjesa e objektivave dhe aktiviteteve, gjegjësisht tek objektivi- Informimi i rregullt i qytetarëve dhe grupeve të interesit për aktivitetet dhe vendimet e kryetarit të komunës; publikimi i akteve të kryetarit të komunës, shqyrtimi i kërkesave, iniciativave dhe peticioneve të qytetarëve të bëhet në vazhdimësi, numri i takimeve konsultative në kuadër të lagjeve, vendbanimeve dhe lokacioneve tjera të bëhet sipas njoftimit zyrtar, gjithmonë në harmoni me Udhëzimin Administrativ për Transparencë në Komuna.

Liridona Fejza-Ajazi-rekomandoi se tek pjesa e objektivave dhe aktiviteteve, shprehimisht tek objektivi-Informimi i rregullt i qytetareve dhe grupeve të interesit për aktivitetet dhe vendimet e kuvendit të komunës dhe komiteteve; si dokument referues të futet edhe Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës.

Arton Hasani-si anëtar i komisionit, rekomandoi se fazat e zhvillimit të Planit të Veprimit për Transparencë Komunale të jenë të inkuorpuara edhe në versionin final të këtij plani, pasi që këto faza kyçe të menaxhimit shtjellojnë në detaje planifikimin, zbatimin dhe raportimin e këtij plani. Gjithashtu sugjeroi se tek objektivi-Ngritja e cilësisë së konsultimeve të politikave dhe akteve të komunës përmes zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në nivel lokal; Informimi për dokumentet, projekt-aktet, mënyrat dhe format e konsultimit, vendin dhe afatet e konsultimit publik të bëhet sipas Udhëzimit Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

Për fund, kryetari i komisionit për hartimin e planit, Bekim Dobra, falënderoi anëtarët e komisionit për sugjerimet e dhëna, njëherësh poñoj se draft-i i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit së bashku me inputet do të publikohet në ueb-faqen e komunës në mënyrë që edhe qytetarët të japin kontributin e tyre.

Publikimet:

Publikimi i këtij dokumenti për konsultim publik u bë me datë 02.02.2023 i cili ishte i hapur për sugjerime dhe rekomandime deri më 10.02.2023.

Në ueb-faqe zyrtare të komunës:

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/category/konsultimet-publike-al/>

Në facebook-un e komunës:

<https://www.facebook.com/komunadrenas> ,si dhe

Në platformën e konsultimeve publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41747>

Konsultimi publik me qytetarët u caktua të mbahet me datë 13.02.2023 në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 11:00.

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/news/ftese-per-konsultim-publik-lidhur-me-planin-e-veprimit-per-transparence-ne-komunen-e-drenasit-2023-2027/>

Paraqitja tabelore:

Takimi i drejtpërdrejtë me qytetarë: Draft-Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027			
Data:	13.02.2023	Koha:	11:00-11:30
Vendi:	Salla e Kuvendit Komunal-Drenas		
Pjesëmarrësit:	Femra	Meshkuj	Totali
	34	12	46
Komente dhe sugjerime:	2		
Kërkesa të pranuar:	1		

Komentet:

Ksamil Ramadani- Prezantimi i këtij plani na tregon që është punuar nga një grup profesionistësh, andaj vlerësoj dhe shpresoj që ky plan ta gjejë zbatueshmërinë ashtu edhe siç është prezantuar.

Blerentina Gashi- Fillimisht ju përgëzoj për punën dhe angazhimin që keni treguar në hartimin e këtij plani kaq të rëndësishëm, ndashtu kërkoj që të formohet një grup për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë.

Kryetari i komisionit për hartimin e planit, Bekim Dobra-Falënderoi të pranishmit për komentet dhe sugjerimet. Ndërkaq, sa i përket sugjerimit/kërkesës për formimin e grupit për monitorimin e zbatimit të këtij plani; ky i fundit u përgjigj se tashmë ekziston grupi punues dhe është i ngarkuar me përgjegjësinë edhe për monitorimin e zbatimit të planit.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky raport është rezultat i një procesi vlerësues i cili pasqyron të dhënat dhe aktivitetet e përmbledhura në një format të shkurtër.

Raporti është paraqitur me objektiva, aktivitete, bartës të aktiviteteve si dhe me afate kohore ku edhe ofron një pasqyrë të qartë dhe me informacione më konkrete rreth hartimit të Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për formimin e komisionit komunal për hartimin e planit,
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik,
4. Foto nga konsultimi publik me qytetarët,
5. Lajmi për mbajtjen e konsultimit publik.

Përpiluar nga:

Arton Hasani



Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave

Monitoruar nga:

Bekim Dobra



Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun



REPUB LIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit/Glllogoc
Zyra e Kryetarit

Nr. 01-020/04-60956 dt: 23.11. 2022

Në vështrim të nenit 13, 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit Komunal për hartimin e Planit të Veprimit për Përmbushjen e Transparencës Komunale 2023-2026

- I.** Anëtarët e Komisionit Komunal për hartimin e Planit të Veprimit për Përmbushjen e Transparencës janë :
 1. Bekim Dobra, Kryetar i Komisionit
 2. Altina Mulaj, Anëtare,
 3. Avdyl Mziu, Anëtarë,
 4. Liridona Ajazi, Anëtare,
 5. Arton Hasani, Anëtarë,
- II.** Komisioni ka për detyrë të hartojë Planin e Veprimit për Përmbushjen e Transparencës Komunale 2023-2026, të dërgon për konsultim publik draftin e Planit dhe gjitha procedurat tjera ligjore deri në miratimin e Planit.
- III.** Komisioni Komunal për hartimin e Planit të Veprimit për Përmbushjen e Transparencës Komunale 2023-2026, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Vendimi i dërgohet :

- Zyrës së Kryetarit
- Përfaqësuesve të komisionit :
- Arkivit të Komunës:



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit/Glllogoc
Zyra e Kryetarit

Nr. 01-070103-6411 dt: 02/02/2023

Komuna e Drenasit, përmes grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027, duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), 01 Nr.110-6904 dhe Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Komuna e Drenasit/Glllogocit lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 02.02.2023 deri më datën 10.02.2023, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me datën 13.02.2023 në Sallën e Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 11:00.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri më datën 10.02.2023 në ora 16:00 ne këto adresa; bekim.dobra@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net

Për më shumë detaje për Draft-Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027, mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme ku është publikuar ky draft dokument;

Ueb faqja zyrtare e Komunës në rubrikën Konsultimet Publike, ne këtë link:
<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/category/konsultimet-publike-al/>

Platforma për Konsultime Publike:
<https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php>

Rrjetin social të Facebook:
<https://www.facebook.com/komunadrenas>

Udhëheqës i Zyres për Komunikim me Publikun



Bekim Dobra

**LISTA E PJESËMARRËSVE NË KONSULTIM PUBLIK PËR DARFT-PLANIN E VEPRIMITI PËR
TRANSPARENÇË NË KOMUNËN E DRENASIT 2023-2027**

Nr	Emri dhe mbiemri	Fshati/vendbanimi	Numri i telefonit	Nënshkrimi
1	Shaki Belushi	K. e Gjermany		Shaki
2	Mensur Akseri	Verboç		Shaki
3	Simuni P. D. D. D. D.			Shaki
4	Arbeni I. D. D. D.	Verboç		Shaki
5	Agreni J. J. J.	Shaki		Shaki
6	Arbeni B. B. B.	Shaki		Shaki
7	Indire Olluri Thaci	Hapushnik	044 825 746	Arbeni
8	Arbeni Rumi	Sankov	049 132 017	Arbeni
9	Erlona Gashi	Dobroshe	049 264 325	Arbeni
10	Qendrim Gllanov	Verboç	049 629 311	Arbeni
11	Ksami I. P. P. P.	Zabeli, ultë	048 850 632	Arbeni
12	Floriana Hasi	Drenas	044-666-482	Arbeni
13	Leonora Shala	Vusat	049-523-096	Arbeni
14	ARLINDË ZOGU	KOMORAN		Arbeni
15	FITORE MORINA	D. RENAS		Arbeni
16	Haxhete Elezi	DRENAS		Arbeni
17	Muhamed Gjergja	Toshtenik	049800029	Arbeni
18	Zefir P. P. P.	Palçik	049-778-973	Arbeni
19	Arbenita B. B. B.	H. B. B. - Toshtenik	049-341-946	Arbeni
20	Blendi Gashi	Palçik	049-789-642	Arbeni
21	Arbeni X. X. X.	Toshtenik	048-160-195	Arbeni
22	Arbeni X. X. X.	KOMORAN		Arbeni

23	Novelije Joca 17.6.7. Jan	Gradice	049/978-282	Novelije
24	Rezatir Prokajin	Verboc	049/282/880	Rezatir
25	VALDETE GASH	POKLEK	-10	Valdete
26	BLEETA GASHI	POKLEK		Bleeta
27	Bekim Dobro	Drenas	049 977 799	Bekim
28	ARTON HASANI	DRENAS	068 561 215	Arton
29	AVDYL MZIU	KOMORAN	049 221 880	Avdyll
30	ALBERT SINANI	DRENAS	049 357 955	Albert
31	Alin Muluq	Zahel Jan	065-532-608	Alin
32	Gendare Moron	Baice	049/978-926	Gendare
33	Erlind Krasnigji	Negroc	049/978-030	Erlind
34	Liridone Fejzi-Ajti	Komoran	049-616-011	Liridone
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				
44				
45				

Nr.	Name/Surname Emri/Mbleri	Institution Institucioni	Position Pozita	Phone-E-mail Tel.-E-mail	Signature Nenshkrimi
1.	Florentina Sylaj	NEKOC	AMVISE	KL 048303105	
2.	MINAVERG SHABANI	NEKOC	AMVISE	045 04451878	
3.	ZYMRIDE DUBOVA	NEKOC	AMVISE	045-977-793	
4.	LAUDIZE DERISHA	NEKOC	AMVISE	048-303836	
5.	MEVLIDE SYLAJ	NEKOC	AMVISE	044989889	
6.	FATIME DENAKU	NEKOC	AMVISE	045589014	
7.	FLORENTA THAQI	NEKOC	AMVISE	045-794-337	
8.	Zahire Boobingera Sylaj	Romania Kosova	AMVISE	049-977-923	

9	QEMINE BYTYCI	POIIC	045-231-846	Q3Tpm
10	NATMIJE LUKIC	POIIC	044-303-862	Q3Tpm
11	Hazir Elshari	Komunar granas	049-413-118	Q3Tpm
12	SHOPIE KUKAJ	NikOC	MESINDHENSE	049-929-037
				Q3Tpm





Republika e Kosoves
Glllogoc

(<https://kk.rks-gov.net/glllogoc>)



A

A

Mbahet konsultimi publik për Draft-Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027

2023/02/13 - 4:31

Mbahet konsultimi publik për Draft-Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027

Të hënën, në sallën e Kuvendit të Komunës, është mbajtur konsultimi publik me qytetarë, për të diskutuar draft-Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027, ku para të pranishmëve është prezantuar ky dokument.

Hapja e konsultimit publik u bë nga Bekim Dobra, udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun në Komunën e Drenasit, i cili edhe ka bërë prezantimin e këtij dokumenti, ku ka treguar për synimet, objektivat dhe aktivitetet e komunës për miratimin dhe zbatimin e planit. Dobra tha se ky dokument, grupi punues e ka ndarë me gjithë qytetarët e Komunës, pasi ky dokument është i publikuar edhe në rrjetin social të Komunës, platformën e konsultimeve publike si dhe në ueb faqen zyrtare të Komunës.

“Plani i Veprimit për Transparencë është hartuar nga Grupi Punues i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës dhe pjesë e grupit kanë qenë zyrtar të komunës. Të gjitha komentet dhe sugjerimet e dhëna, janë inkorporuar në këtë plan të cilin e keni para vetës

dhe nëse keni ndonjë koment në do ta marrim parasysh dhe do t'i diskutojmë me anëtarët e grupit punues në takimin e fundit ku edhe do t'i diskutojmë komentet", ka thënë mes tjerash Bekim Dobra.

Në këtë diskutim publik, kanë marr pjesë qytetarë, ku edhe kanë dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre në hartimin e këtij plani.

Për hartimin e këtij plani, është formuar Grupi Punues i përberë nga Bekim Dobra, Altina Mulaj – Hajdini, Avdyli Mziu, Liridona Fejza-Ajazi dhe Arton Hasani, ku edhe ka hartuar këtë draft dokument. Draft-Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027, ka qenë në diskutim nga data 02.02.2023 deri më datën 10.02.2023 në tri platforma, në ueb faqen zyrtare të komunës, në platformën për konsultime publike ne kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe në rrjetin social Facebook, po ashtu janë dhënë edhe e-mail adresat për të pranuar komentet edhe në formën elektronike ku të gjithë qytetarët kanë pasur mundësinë të japin sugjerime e komentet e tyre në këtë dokument.

Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit, pritet të miratohet në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.



ADRESA

Rr. "Fehmi Lladrovci" Drenas

Kodi postal: 13000

KONTAKTO

TEL: 03820040800

EMAIL: komuna.drenas@rks-gov.net

THIRRJE PA PAGESE:

080013050

VEGEZA

- Webfaqja e vjeter e komunes (<https://kk-arkiva.rks-gov.net/gllogoc>)
- Gazeta zyrtare (<https://gzk.rks-gov.net/>)
- Portali i Qeverisë (<https://www.rks-gov.net>)
- Prokurimi publik i Kosovës – KRPP (<https://krpp.rks-gov.net/>)
-  Instituti GAP (<http://www.institutigap.org/spendings/?drenas/2018#/~/~drenas>)
- Organi Shqyrtues i Prokurimit (<https://oshp.rks-gov.net/>)
- Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Koso (<https://arbk.rks-gov.net/>)
- Deklarimi i Pasurisë (<http://www.akk-ks.org/sq/deklarimet#indexmain>)
- Kyçje në e-mail zyrtar (<https://mail.rks-gov.net/OWA>)
- Raporto Ankesën (<https://ndreqe.com/>)
- Si të pajisemi me leje ndërtimore (<https://dphnb.rks-gov.net/>)
- <http://www.voc-up.com> (<http://www.voc-up.com>)
-  Qeveris Mirë – Qeveris Mirë (<http://qeverismire.info/shq/>)

FAQET

- Drenas (<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/>)
- GEOportal (<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/drenas/autorizime/>)

RRJETET SOCIALE